



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafin 2.6, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet të OST/OT);
- Aplikacioni i KOSTT për të Hyrat dhe Tarifat e Lejuara;

**Në mbledhjen e mbajtur më datë 20 qershor e miratoi këtë:**

**VENDIM**

**TË APROVOJË TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga tarifat dhe ngarkesat e rregulluara që do të aplikohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT) si Operator i licencuar i Sistemit të Transmisionit dhe Operator i licencuar i Tregut për vitin relevant (tarifor) prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013.

**Arsyetim**

- I. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT aplikacionin për aprovim të MAR-it që duhet të mbulohet nga OST/OM përmes tarifave dhe ngarkesave të rregulluara që do të hyjnë në fuqi nga 1 qershori 2012.
- II. Në marrjen e vendimit të tij që MAR të mbulohet nga OST/OT e licencuar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
  - Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifës së Energjisë elektrike 2012 (ETR6) – raporti konsultues i KOSTT,
  - Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifës së Energjisë elektrike 2012 (ETR6) – Përgjigjet ndaj komenteve, të publikuar më 20 qershor 2012.



- III. Duke i marrë parasysh dispozitat ligjore të përmendura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.
- IV. MAR që do të mbulohet nga OST/OT e licencuar për periudhën prej 12 muajve nga 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013 është caktuar si **€17,336,245**.
- V. OST/OT, përmes këtij Vendimi, udhëzohet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së, brenda 15 ditëve të datës së këtij vendimi, tarifat dhe ngarkesat e saja të propozuara të rregulluara për mbulimin e MAR-it të përcaktuar me këtë Vendim.
- VI. Tarifat dhe ngarkesat e rregulluara do të kalkuloohen sipas metodologjive ekzistuese e që janë aprovuar për këtë qëllim nga ZRRE.
- VII. OST/OT së licencuar do t'i lejohet të mbulojë, në vitet në vazhdim, çdo ndryshim në mes të MAR-it të përcaktuar me këtë Vendim dhe atë që do të mbulohet përmes tarifave dhe ngarkesave të rregulluara të aprovuara, aty ku ky ndryshim është për tarifat dhe taksat e rregulluara që aprovohen për të hyrë në fuqi në një datë më vonë se 1 prill 2012.
- VIII. Ky vendim është lëshuar në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbizotëroj versioni i gjuhës shqipe.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë para Gjykatës kompetente kundër këtij vendimi brenda katërbëdhjetë (14) ditëve pas marrjes së saj apo publikimit të saj në ueb faqen e ZRRE-së, cilado të ketë ndodhur e fundit.

#### **Bordi i ZRRE**

---

Enver Halimi, Kryesues

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar

---

Merita Kostari, Anëtare

---

Krenar Bujupi, Anëtar